

POP 5


Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1



Të shtëna me armë zjarri në Shkodër, plagoset një person! Qëllohet teksa po lëvizte me makinë

2



Vladimir Putin telefonat me kancelarin gjerman

3



Lufta në Ukrainë, ja gjigandët e industrisë që 'braktisen' Putin! Sa 'thika' mbi ekonominë ruse?

4



Shoqata e Transportit kërkon rritjen e çmimit të biletave, Bashkia Tiranë: Nis disbursimi i subvencionit për transportin publik, do përfitojnë 1 milionë euro

5



'Nuk më dëgjuat', paralajmërimi i Bragës: Në tetor iu thashë të mbillni grurë, tani është koha për

Kronikë

# Qëllohet në drejtim të 43-vjeçarit në Lezhë, biznesmeni u shpëton plumbave! Në vitin 2020 mbeti i plagosur nga një atentat! Mister autorët

Një 43-vjeçar i ka shpëtuar atentatit për herë të dytë në Lezhë. Aleksandër Deda, 43-vjeç ka qenë shënjestër e atentatorëve, ashtu si edhe në dhjetorin e vitit 2020 ku mbeti i plagosur. Policia ka nisur krehjen e zonës dhe ka shoqëruar disa persona



Aleksander Deda



REPORTOI Chat live me Shqiptaria.com



Zgjidhja e fiskalizimit po ju lë pa punë dhe pa gjumë?

Kaloni në devpos dhe mos paguani asgjë për periudhën e mbetur të kontratës suaj aktuale!

www.devpos.al

devpos@dev.al

045 620 461



HOROSKOPI

Nje det me oferta te pret...

zbulu me teper ne booking.adriaferries.com



...në shtet të emocijave!

**LEZHË-** Një biznesmen në Lezhë ra pre e një atentati me armë zjarri për herë të dytë brenda dy vitesh, por fatmirësisht nuk mori lëndime. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 14 e 15 minuta të së hënës në një lokal në dalje të qytetit të Lezhës, ndërsa shënjestër e sulmit ishte 43-vjeçari Aleksandër Deda. Sipas policisë ka qenë vetë biznesmeni i cili ka denoncuar atë çfarë i ka ndodhur dhe shërbimet e policisë kanë shkuar menjëherë në vendngjarje. Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe krehjes së zonës blutë nuk kanë konstatuar gëzhjoja, por sipas të dhënave në drejtim të biznesmenit Deda është qëlluar disa herë më pistoletë nga një person që ndodhej në një makinë në lëvizje.

Fatmirësisht asnjë nga plumbat nuk e preku 43-vjeçarin, ndërsa autoret arritën të largohen dhe ende nuk janë identifikuar nga policia. Në vendin e ngjarjes janë kryer të gjitha veprimet hetimore dhe në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar kamerat e sigurisë të disa bizneseve në zonë të cilat po analizohen me qëllim identifikimin e autorëve.



[Sh.com]

LEXO EDHE:

8 marsi i grave afgane nga qendra e tyre në Shëngjin të Lezhës, Komuniteti afgan sjell në kujtesë vështirësitë e bashkëkombësve të tyre nën pushtetin taleban

Kjo është hera e dytë që **biznesmeni Aleksandër Deda** bie pre e sulmit me armë e zjarrit. Në vitin 2020 ai mbeti i plagosur në shpatull, ndërsa u qëllua teksa lëvizte me makinën e tij në superstradën Lezhë-Laç. Ndonëse i plagosur ai arriti të largohet, duke shkuar vetë në urgjencën e spitalit rajonal të Lezhës ku dhe mori ndihmën e parë mjekësore. Autoret u larguan me shpejtësi dhe automjeti i tyre u gjet i djegur në fshatin Pllanë të Lezhës. Aleksandër Deda i njohur ndryshe dhe me nofken "Leksi i Druve", nuk njihet si personazh problematik dhe me precedent penal në Shqipëri. Deda ka një ndër lokalet më të frekuentuara në hyrje të Lezhës, pranë mbikalimit. Pavarësisht hetimeve policia nuk ka arritur të zbardhe ende atentatet e përsëritura ndaj tij.



BUNK'ART 1

M.Q./Shqiptaria.com

TAG: 

Lezhe

atentat

Aleksandër Deda

Komento

Komente

Mond:

09/03/2022 02:22

Qa je duke pritur more njeri ata e kan nda mendjen me te hek nga kjo bot kushdo qe esht , po merr masa ,i thon nja shprehje te vjeter ma mire te qaje nena e atij se e imja .

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Lajme të tjera

Sociale



Përplasja Moskë-Kiev/ Refugjatët afganë në Shëngjin: Kemi frikë se konflikti do të na vonojë vizat drejt SHBA! E ndiejmë dhimbjen e ukrainasve



Elvis Hila

8 Mars, 12:23

Kronikë




Grabiti me dhunë një familje në Kurbin, arrestohet duke hyrë në Shqipëri Gilmando Bami

8 Mars, 10:46

Kultura



Muret antike në Lezhë kthehen në banjë publike! Ndotet zona arkeologjike tek vendvarrimi i Skënderbeut



Elvis Hila

7 Mars, 09:19

Kronikë



Atentati ndaj 33-vjeçarit në Vlorë, shoqërohen 7 persona! Autorët kishin ndjekur lëvizjet e tij, e qëlluan me 15 plumba! Po hetohet për konfliktet për pazare droge

6 Mars, 07:21

Kronikë



Atentat në Vlorë, qëllohet me breshëri plumbash 33-vjeçari, plagoset rëndë! Gjendet e djegur në zonën e 'Ujit të Ftohtë' makina e autorëve, dy kallashnikovë brenda

5 Mars, 20:45

Ekonomi



FOTOLAJM/ I frikësuar nga rritja e mëtejshme e çmimit të naftës, qytetari në Lezhë merr masa! Mbush bidona të tërë me karburant për t'i patur rezervë

5 Mars, 15:10

Kronikë



Vrasja e rapsodit dhe mikut të tij, del ekspertiza e armëve të krimit në ngjarje: U përdorën nga 2 persona! Në burg ndodhen dy vëllezërit Përdoda

5 Mars, 10:30

Kronikë



Aksident në Lezhë, automjeti përplas këmbësorin, përfundon në spital

3 Mars, 17:46

Kronikë



Aksident në aksin Lezhë-Shëngjin, makina përplaslet me betonieren, plagoset një pasagjer (VIDEO)

3 Mars, 12:10

Politikë



Unioni i Bashkive Shqiptare të Rajonit përkujton 578-vjetorin e Besëlidhjes së Lezhës, Veliaj: Na duhet një Besëlidhje e Re e shqiptarëve drejt Europës

2 Mars, 14:50

Lajme nga emisionet



Frymëzuese/ Lezhjani hap dyert e shtëpisë së tij për dy familje ukrainase: E di çfarë do të thotë të vuash, e ndjej të bëj doçka për njerëzit në nevojë! Edhe një mesazh politik

2 Mars, 13:04

Sociale



Qytetari lezhjan hap dyert e shtëpisë për të ikurit nga lufta e Ukrainës: Të mirëpritur, strehim dhe ushqim falas

1 Mars, 19:26

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

[Shqiptaria.com]

Kërko

Q

© 2011 - 2022 Shqiptaria.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje